



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Data 25.03.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale të stampuara dhe produkte të lidhura me to 22

Libra të shtypur, broshura dhe fletëpalosje 22100000-1

Kartolina 22310000-6

Printime dhe shërbime të lidhura 79800000-2

Shërbime të printimit dixhitale 79811000-2

Shërbime të dizajnit grafik 79822500-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 793 950 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Korçe** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe pika 3, neni 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së perlllogaritur te kontrates qe prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij **nje dizenjator, me eksperience te pakten 1 vjecare ne fushen e dizenjimit**, te punesuar me kohe te plote dhe te perfshire ne listpagesa **për muajin e fundit të** deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-Kontraten e punes

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar me procesverbalin e mbajtur prej tij date 17.03.2026 si më poshtë:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Duke qene se ne termat e references dhe specifikimet teknike ne shumicen e zerave eshte parashikuar qe ofertuesit duhet te bejne dhe dizenjimin e materialeve eshte i nevojshem qe dizenjatori te jete pjese e stafit te ofertuesit. Gjithashtu me qellim qe sherbimi i dizenjimit te jete cilesor dhe konform kerkesave te autoritetit kontraktor kerkohet qe dizenjatori te kete te pakten nje eksperience 1 vjecare ne fushen e dizenjimit.

Objekti i prokurimit përfshin jo vetëm printimin, por edhe hartimin grafik dhe dizenjimin e materialeve promocionale (banera, broshura, fletëpalosje, materiale informuese, etj.), të cilat përbëjnë një element thelbësor të cilësisë së shërbimit.

Për këtë arsye, kërkesa për një dizenjator të punësuar me kohë të plotë garanton që operatori ekonomik ka kapacitete reale dhe të qëndrueshme, dhe nuk mbështetet në burime të jashtme të pasigurta.

Kërkesa për eksperiencë minimale 1-vjeçare është proporcionale dhe jo diskriminuese, pasi siguron një nivel minimal profesionalizmi pa kufizuar konkurrencën.

Përfshirja në listëpagesa garanton marrëdhënie të rregullt pune dhe shmang përdorimin formal të stafit vetëm për qëllime kualifikimi.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e produktit final dhe është i domosdoshëm për realizimin korrekt të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 5 persona** dokumentuar kjo me Vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te

Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi , **për muajin e fundit të** deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “ Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punes i argumentuar me procesverbalin e mbajtur prej tij date 17.03.2026 si më poshtë:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

1 dizenjator, 1 punonjes qe do te merren me montimin e banerave, adeziveve dhe materialeve te tjera sipas specifikimeve, 1 shofer, 2 punonjes qe do te kujdesen per printimin dhe organizimin e materialeve te kerkuara.

Duke analizuar natyrën e shërbimit, konstatohet se realizimi i kontratës përfshin disa procese paralele: dizejnim grafik, përgatitje për printim, printim, montim dhe instalim materialesh (banera, adezivë, etj.), transport/logjistikë. Për këtë arsye, numri minimal prej 5 punonjësish është përllogaritur mbi baza funksionale konkrete:

1 dizenjator,

2 punonjës për procesin e printimit dhe përpunimit,

1 punonjës për montim/instalim,

1 shofer për transportin dhe shpërndarjen.

Ky numër është minimal dhe proporcional me volumet e parashikuara, garanton vazhdimësi në shërbim dhe përballim të fluksit të punës, shmang rrezikun e vonesave apo mosrealizimit të kontratës.

Kërkesa për dokumentim përmes listëpagesave dhe sigurimeve shoqërore siguron që stafi është real dhe i disponueshëm.

2.2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

-Makineri shtypi

-Printer dixhital

-Pajisje laminuese

*Sqarim: Me pajisje laminuese nenkuptohet makineria për plastifikim ose makineria për ngjitje.

Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese: foto per secilen nga pajisjet shoqeruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë ose posedimin mbi pajisjet e mesiperme (psh. fatura blerje,deklaratë zhdoganimi, kontratë qeraje, kontratë dhurimi dhe cdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për disponimin/posedimin e pasurive të luajtshme)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “ Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”,të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar me procesverbalin e mbajtur prej tij date 17.03.2026 si më poshtë:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknikedhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

-Makineria e shtypit nevojitet për realizimin e zerave të preventivit

-Pajisja laminuese (makineria për plasifikim ose ngjitje) nevojitet për realizimin e zerave ku është parashikuar plastifikimi dhe ngjitja e materialeve.

- Printer dixhital: Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje printimi profesionale që mundësojnë printim cilësor në materiale të ndryshme, përfshirë sipërfaqe të forta si forex, plastike apo materiale të ngjashme, me rezistencë ndaj faktorëve të jashtëm.

Duke qenë se objekti i prokurimit është i natyrës tekniko-produktive, pajisjet e kërkuara janë thelbësore dhe të lidhura drejtpërdrejt me realizimin e shërbimit:

Makineri shtypi: Është pajisja bazë për realizimin e printimeve në volum (broshura, postera, fletëpalosje, etj.). Pa këtë pajisje, operatori nuk mund të realizojë objektin e kontratës në mënyrë autonome.

Pajisje laminuese (plastifikim/ngjitje): Kërkohet për përpunimin përfundimtar të materialeve promocionale, duke rritur qëndrueshmërinë, cilësinë vizuale dhe rezistencën ndaj faktorëve të jashtëm (lagështirë, konsum fizik). Është e domosdoshme për zërat ku parashikohet plastifikimi apo aplikimi i materialeve ngjitëse.

Printer digjital: Printeri dixhital është i domosdoshëm për realizimin e materialeve në formate të mëdha (baner, roll-up, city light), printimeve mbi materiale të ndryshme si adeziv, forex, materiale plastike, produkteve promocionale që kërkojnë personalizim të shpejtë dhe fleksibilitet në prodhim. Kjo pajisje siguron fleksibilitet në realizimin e porosive të ndryshme, mundësi printimi në sipërfaqe dhe formate të ndryshme, cilësi të lartë grafike dhe rezistencë të materialeve, sidomos për përdorim të jashtëm.

Kërkesa për foto të pajisjeve dhe dokumentacion pronësie ose posedimi synon të garantojë që operatori ekonomik ka akses real dhe të menjëhershëm në këto mjete.

Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcional, pasi përfshin vetëm pajisjet minimale të nevojshme, nuk kufizon konkurrencën, pasi lejon edhe forma të tjera posedimi (qira, huapërdorje, etj.).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Fondi limit, sasite, termat e references, specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta të pranimit (2.2.2, 2.2.3 dhe 2.2.4) janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin Nr 167 date 20.02.2026 sipas procesverbalit të mbajtur prej tyre.

Specifikimet teknike janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për materialet objekt prokurimi të cilat do të ndihmojnë Autoritetin Kontraktor në proceset e punës për kryerjen e detyrave funksionale. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Në respektim të nenit 36 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.